

Pasaportat dhe lejet e kalimit

Pasaportat

Ambasada e RSh Vjenë ka filluar shërbimin e ri të aplikimit për pasaporta dhe karta ID. Të gjithë qytetarët shqiptarë, të cilët janë të interesuar për këtë shërbim dhe jetojnë e kanë një leje qëndrimi në Austri, luten të aplikojnë për këtë shërbim pranë Ambasadës së RSh Vjenë. Mënyra e aplikimit për këtë shërbim është si më poshtë:

Faza e parë:

- 1- Klikoni në portalin www.e-albania.al
- 2- Klikoni butonin ,Regjistrohu‘
- 3- Plotësoni të dhënat personale që ju kërkohen dhe përfundoni regjistrimin. Më pas do dërgohet një kod me 4 shifra në numrin tuaj të telefonit ose në emailin tuaj. Atë kod duhet ta vendosni në portal në kuadratin që ju kërkohet dhe në këtë mënyrë regjistrimi përfundohet me sukses.

Faza e dytë:

- 1- Klikoni në portalin www.e-albania.al
- 2- Klikoni butonin ,Hyr‘
- 3- Vendosni numrin personal, që ndodhet në fund djathtas të dokumentit tuaj të identifikimit dhe hyr në portal.
- 4- Kërkoni për shërbimin ‘Aplikim për kartë identiteti dhe pasaportë’
- 5- Krijo një aplikim të ri
- 6- Plotëso formularin e aplikimit, duke zgjedhur shtetin Austri dhe zyrën konsullore Vjenë
- 7- Zgjidhni datën dhe orën e takimit në Ambasadë.
- 8- Përfundo aplikimin.
- 9- Prisni për emailin e konfirmimit për pranimin e aplikimit tuaj.

Për çdo vështirësi të hasur në aplikimin tuaj për këtë shërbim, lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit +43 1 328 86 56.

Stafi i Ambasadës është i gatshëm për t’ju asistuar për të marrë shërbimin e nevojshëm. Ju kujtojmë që vendosja e maskave FFP2 dhe ruajtja e distancës në ambjentet e ambasadës është e detyrueshme.

Ju faleminderit!

Lejet e kalimit

Ambasada pajis me lejekalimi shtetasit shqiptarë që nuk kanë dokument të vlefshëm udhëtimi për tu kthyer në Shqipëri.

Leja e kalimit ka afat vlefshmërie jo më shumë se 10 ditë. Për të bërë kërkesën për leje kalimi, shtetasi shqiptar duhet të aplikojë online duke ndjekur linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9489 dhe duhet të paraqitet personalisht në ambasadë para punonjësit konsullor dhe të motivojë nevojën për pajisjen e tij me këtë dokument.

Për konfirmimin e identitetit të tij, ambasada merr në konsideratë dokumentacionin mbështetës të paraqitur.

Kur bëhet fjalë për lëshimin e një lejekalimi për të mitur (mosha nën 18 vjeç), para punonjësit konsullor së bashku me fëmijën duhet të jenë të pranishëm të dy prindërit, ose të paktën njëri prej tyre, por me prokurë përfaqësimi për tjetrin. Në rast se fëmija ka vetëm një prind ose ka një kujdestar, kërkesës për leje kalimi i bashkëlidhen dokumentet që konfirmojnë kujdestarinë mbi fëmijën.

Duke qenë se me leje kalimi pajisen vetëm shtetasit e RSh-së, është kusht për lëshimin e leje kalimi për fëmijë (edhe të sapo lindur) që të jenë të regjistruar më parë në Zyrat e Gjëndjes Civile në Shqipëri.

Bëhet përjashtim për prezencën e shtetasit në rastet kur ai:

- Është i ndaluar, arrestuar ose burgosur. Në këtë rast lejohet pranimi i kërkesës së bërë nga zyra e të huajve që merret me veprimet e kthimit në atdhe të personave që nuk kanë të drejtë qëndrimi në Austri;
- për arsye të forta shëndetësore nuk mund të paraqitet në përfaqësi. Në këtë rast kërkesën e bëjnë familjarët dukeparaqitur një deklaratë përfaqësimi dhe dokumente të tjera bindëse. Sipas mundësive, punonjësi konsullor shkon dhe bën verifikimin në spital apo në vendin ku ndodhet i sëmuri.

Vërtetimi i identitetit bëhet me një nga dokumentet e mëposhtme:

- Pasaportë e pavlefshme;
- Kartë identiteti origjinale;
- Çertifikatë lindje nga gjendja civile përkatëse, e lëshuar jo më shumë se 3 muajt e fundit nga data e kërkesës, e shoqëruar me kopjen e kartës së identitetit;
- Leje drejtimi automjeti.

Në rast se kërkesa për leje kalimi bëhet për arsye të humbjes së pasaportës, atëherë kërkuesi i lejes së kalimit duhet të paraqesë në ambasadë edhe dokumentin e denoncimit në polici për humbjen e pasaportës, të pajisur me Vulë Apostile dhe të përkthyer në shqip. Denoncimi mund të bëhet edhe në ambasadë përpara konsullit.

Përveç dokumenteve të mësipërme, shtetasi që kërkon lejen e kalimit duhet të sjellë me vete edhe dy fotografi aktuale pasaporte 4 x 5 cm, ,dëshminë e pagesës prej 30€ të kryer në llogarinë e ambasadës për shërbimet konsullore dhe bileta e udhëtimit të shtetasit drejt Shqipërisë;. Cdo pagesë e kryer nga shtetasit për shërbime konsullore do të duhet të jetë e barazlefshme me vlerën e pullës konsullore, e cila vendoset në dokument.